



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 281, datë 29.05.2024**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 236, DATË 24.05.2023, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjqësor, në mbledhjen e datës 29.05.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, të kandidatës znj. {...}, si dhe kërkesën e saj për heqjen dorë nga ky kandidim”, përgatitur nga relatori z. Ridvan Hado, si shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe propozimin për përfundimin e kësaj procedure nga relatori i çështjes

**V Ë R E N**

**I. TË DHËNA PËR PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË**

1. Këshilli i Lartë Gjqësor, me Vendimin nr. 236, datë 24.05.2023 ka vendosur :

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.*

2. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatës Administrative të Apelit, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë

është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 25.05.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 14.06.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Këshilli, me vendimin nr. 57 datë 07.02.2024 ka vendosur:

- 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

dhe pas shortit të hedhur

- 2. Caktimin e relatorit si më poshtë:**

.... Për kandidaten znj. {...} - z. Ridvan Hado.....

5. Më datë 12.02.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Më datë 27.02.2024, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 18.03.2024, pranë ILDKPKI-së.

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidaten për gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

10. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 236, datë 24.05.2023 është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 236, datë 24.05.2023 përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

11. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

11.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

11.2 Sa i përket kriterit të “*përvojës profesionale minimale*” dhe pikërisht nënkriterit të “*përvojës specifike profesionale*” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative, informacioni u kërkuar referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Korçë<sup>1</sup>, si dhe në Gjykatën e Lartë, referuar faktit se kandidatja ka ushtruar si magjistrate funksionin e ndihmësit ligjor.

12. Bazuar në rezultatet e verifikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në Mbledhjen e datës 29.02.2024, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr. 236, datë 24.05.2023, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

- Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 236, datë 24.05.2023 të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
- Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 236, datë 24.05.2023.

## **II. SHQYRTIMI NË KËSHILL DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATES PËR T’U TËRHEQUR NGA KANDIDIMI**

13. Në Mbledhjen Plenare të datës 13.03.2024, Këshilli pa filluar shqyrtimin e akteve të procedurës së verifikimit të kësaj kandidateje ka vendosur që t’i shqytojë në një mbledhje tjetër së bashku me kandidatët e tjerë që kanë kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, pasur parasysh faktin se kandidatja ushtron funksionin e gjyqtarit në një gjykatë që nuk i përket juridiksionit administrativ.

---

<sup>1</sup> Kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

14. Ndërkohë, me datë 15.05.2024, kandidatja znj. {...} ka parashtruar kërkesë për tërheqjen nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 236 datë 24.05.2023.

15. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 136, pika 1 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin).

16. Këshilli në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit edhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 48 të Ligjit për Statusin, procedura administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi, buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit parashikohet se : *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”*. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

17. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 75/2019. Kështu, në Kreun V, Seksioni B, pika 6, të tij, përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit”*.

18. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja znj. {...}, brenda afatit të kandidimit, ka paraqitur kërkesën për ngritjen në detyrë në Gjykatën

Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 236, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë, pikërisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim në lidhje me këtë, kandidatja u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë ngritje në detyrë, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit kërkesë, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t'u tërhequr nga kandidimi.

### **III. KONKLUZIONE**

19. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t'u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 236, datë 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë, për këtë kandidate.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **V E N D O S I :**

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe

bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**